



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**PROJEKTLIGJI PËR MASAT E PËRKOHSHME TË PRODUKTEVE THEMELORE NË RASTE TË VEÇANTA  
TË DESTABILIZIMIT NË TREG<sup>1</sup>**

**DRAFT LAW ON TEMPORARY MEASURES FOR ESSENTIAL PRODUCTS IN SPECIAL CASES OF  
MARKET DESTABILIZATION<sup>2</sup>**

**NACRT ZAKONA O PRIVREMENIM MERAMA OSNOVNIH PROIZVODA U POSEBNIM SLUČAJEVIMA  
DESTABILIZACIJE NA TRŽIŠTU<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Projektligji për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg, është aprovuar në mbledhjen e 8-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendimin nr.06/08, të datës, 03.04.2026.

<sup>2</sup> Draft Law on Temporary Measures for Essential Products in Special Cases of Market Destabilization, has been in the 08, meeting of the Government of the Republic of Kosovo, with the Decision, No.06/08, dated 03.04.2026.

<sup>3</sup> Nacrt zakona o Privremenim Merama Osnovnih Proizvoda u Posebnim Slučajevima Destabilizacije na Tržištu, usvojeno na 08, Sednici Vlade, sa Odlukom Br.06/08, datum 03.04.2026

<p><b>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</b></p> <p>Në bazë të nenit 51 dhe 65 (1) të Kushtetutës të Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p><b>LIGJ PËR MASAT E PËRKOHSHME TË PRODUKTEVE THEMELORE NË RASTE TË VEÇANTA TË DESTABILIZIMIT NË TREG</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 1</b> <b>Qëllimi</b></p> <p>1. Ky ligj përcakton vendosjen e masave të përkohshme dhe proporcionale për produktet themelore në raste të veçanta të destabilizimit të tregut, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit dhe interesit publik.</p> <p>2. Ky ligj është pjesërisht në Përputhje me Rregulloren e (BE) 2024/2747 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e 9 tetorit 2024, për</p>	<p><b>Assembly of the Republic of Kosovo,</b></p> <p>Based on Article 51 and 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Adopts:</p> <p><b>LAW ON TEMPORARY MEASURES FOR ESSENTIAL PRODUCTS IN SPECIAL CASES OF MARKET DESTABILIZATION</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 1</b> <b>Purpose</b></p> <p>This Law shall establish the imposition of temporary and proportionate measures for essential products in special cases of market destabilization, with the aim of protecting consumers and the public interest.</p> <p>2. This law is partly in compliance with the Regulation (EU) 2024/2747 of the European Parliament and of the Council of 9 October</p>	<p><b>Skupština Republike Kosovo,</b></p> <p>Na osnovu člana 51 i 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p><b>ZAKON O PRIVREMENIM MERAMA OSNOVNIH PROIZVODA U POSEBNIM SLUČAJEVIMA DESTABILIZACIJE NA TRŽIŠTU</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 1.</b> <b>Svrha</b></p> <p>1. Ovaj zakon utvrđuje postavljanje privremenih i proporcionalnih mera za osnovne proizvode u posebnim slučajevima destabilizacije tržišta, u cilju zaštite potrošača i javnog interesa.</p> <p>2. Ovaj zakon je delimično u skladu sa Uredbom (EU) 2024/2747 Evropskog parlamenta i</p>
--	---	---

<p>krijimin e një kornize masash në lidhje me një emergjencë të tregut të brendshëm dhe me qëndrueshmërinë e tregut të brendshëm dhe ndryshimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 2679/98 (Akti për Emergjencën dhe Qëndrueshmërinë e Tregut të Brendshëm).</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 2 Fushëveprimi</b></p> <p>Ky ligj zbatohet ndaj operatorëve ekonomik që merren me prodhimin, furnizimin dhe tregtimin e produkteve themelore, në rastet e destabilizimit të tregut.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizime</b></p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:</p> <p><b>1.1 Produkte themelore</b> - janë produktet e domosdoshme për plotësimin e nevojave bazë të konsumatorëve në rastet e destabilizimit të tregut.</p> <p><b>1.2 Konsumatori</b> - çdo person fizik i cili blen dhe përdor mallra ose shërbime për plotësimin e nevojave të veta, që nuk ka të bëjë me veprimtari tregtare, biznesore,</p>	<p>2024 establishing a framework of measures related to an internal market emergency and to the resilience of the internal market and amending Council Regulation (EC) No 2679/98 (Internal Market Emergency and Resilience Act)</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 2 Scope</b></p> <p>1. This Law shall apply to economic operators engaged in the production, supply and trading of essential products, in cases of market destabilization.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 3 Definitions</b></p> <p>1. Terms used in this Law shall have the following meaning:</p> <p><b>1.1. Essential products</b> - shall mean products necessary to meet the basic needs of consumers in cases of market destabilization.</p> <p><b>1.2. Consumer</b> - any natural person who buys and uses commodities or services to fulfill their needs, for purposes not related to commercial, business, craft or</p>	<p>Saveta, od 9. oktobra 2024. o uspostavljanju mera povezanih sa vanrednim stanjem na domaćem tržištu i sa otpornošću domaćeg tržišta i izmeni Uredbe Saveta (EZ) br. 2679/98 (Akt o vanrednom stanju na domaćem tržištu i otpornosti domaćeg tržišta).</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 2. Delokrug</b></p> <p>1. Ovaj zakon se sprovodi na ekonomske operatere koji se bave proizvodnjom, snabdevanjem i trgovinom osnovnim proizvodima, u slučajevima destabilizacije tržišta.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 3. Definicije</b></p> <p>1. Izrazi korišćeni u ovom zakonu imaju ova značenja:</p> <p><b>1.1 Osnovni proizvodi</b> - su neophodni proizvodi za zadovoljavanje osnovnih potreba potrošača u slučajevima destabilizacije tržišta.</p> <p><b>1.2 Potrošač</b> - svako fizičko lice koje kupuje i koristi robu ili usluge kako bi zadovoljilo svoje potrebe, a koje se ne odnose na trgovinske, poslovne, zanatske</p>
---	--	--

<p>zejtare apo profesionale.</p> <p><b>1.3 Destabilizimi i tregut</b> - nënkupton çdo situatë në të cilën funksionimi normal i tregut çrregullohet, si rezultat i luhatjeve të theksuara në çmime, duke pamundësuar reflektimin e drejtë të kostove, si dhe duke ndikuar negativisht në mbrojtjen e konsumatorit dhe interesin publik.</p> <p><b>1.4 Masë e përkohshme</b> - është ndërhyrje e kufizuar në kohë, e vendosur me qëllim të rregullimit të çmimeve gjatë periudhës së destabilizimit të tregut, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.</p> <p><b>1.5 Bordi i Pavarur për Masat e Përkohshme për Rregullimin e Çmimeve</b> - është organ i pavarur, i themeluar me këtë ligj me qëllim të vendosjes së masave të përkohshme për rregullimin e çmimeve në rrethana të veçanta të destabilizimit të tregut, në bazë të analizës së tregut dhe parimit të proporcionalitetit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 4 Produktet themelore</b></p> <p>1. Produktet themelore në kuptim të këtij ligji</p>	<p>professional activity.</p> <p><b>1.3. Market destabilization</b> - shall mean any situation in which the normal functioning of the market is disrupted, as a result of significant price fluctuations, thereby preventing the fair reflection of costs, as well as negatively affecting consumer protection and the public interest.</p> <p><b>1.4. Temporary measure</b> - shall mean a time-limited intervention, imposed with the purpose of regulating prices during the period of market destabilization, in accordance with the principle of proportionality.</p> <p><b>1.5. Independent Board for Temporary Measures for Price Regulation</b> - shall mean an independent body, established by this Law for the purpose of imposing temporary measures for price regulation in specific circumstances of market destabilization, based on market analysis and the principle of proportionality.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4 Essential products</b></p> <p>1. Essential products within the meaning of</p>	<p>ili stručne delatnosti.</p> <p><b>1.3 Destabilizacija tržišta</b> - podrazumeva svaku situaciju u kojoj se normalno funkcionisanje tržišta poremećuje, kao rezultat izraženih oscilacija u cenama, onemogućavajući pravo odražavanje troškova, kao i negativno utičući na zaštitu potrošača i javnog interesa.</p> <p><b>1.4 Privremena mera</b> - je vremenski ograničena intervencija, postavljena u cilju regulisanja cena tokom perioda destabilizacije tržišta, u skladu sa principom proporcionalnosti.</p> <p><b>1.5 Nezavisni odbor za privremene mere regulisanja cena</b> - je nezavisni organ, osnovan ovim zakonom u cilju postavljanja privremenih mera za regulisanje cena u posebnim okolnostima destabilizacije tržišta, na osnovu analize tržišta i principa proporcionalnosti.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 4. Osnovni proizvodi</b></p> <p>1. Osnovni proizvodi u značenju ovog</p>
---	---	---

janë:	this Law shall be:	zakona su:
1.1. Drithërat;	1.1. Grains;	1.1. Žitarice;
1.2. Mielli;	1.2. Flour;	1.2. Brašno;
1.3. Buka;	1.3. Bread;	1.3. Hleb;
1.4. Orizi;	1.4. Rice;	1.4. Pirinač;
1.5. Makaronat;	1.5. Pasta;	1.5. Makarone;
1.6. Vaji ushqimor;	1.6. Edible oil;	1.6. Jestivo ulje;
1.7. Qumështi dhe produktet e qumështit;	1.7. Milk and dairy products;	1.7. Mleko i mlečni proizvodi;
1.8. Uji;	1.8. Water;	1.8. Voda;
1.9. Pemët dhe perimet;	1.9. Fruits and vegetables;	1.9. Voće i povrće;
1.10. Kripa e kuzhinës;	1.10. Table salt;	1.10. Kuhinjska so;
1.11. Vezë pule;	1.11. Chicken eggs;	1.11. Kokošja jaja;
1.12. Mishi;	1.12. Meat;	1.12. Meso;
1.13. Sheqeri kristalor;	1.13. Crystal sugar;	1.13. Kristalni šećer;
1.14. Ushqimet bazë për fëmijë;	1.14. Basic food for children;	1.14. Osnovna hrana za decu;
1.15. Produktet e higjienës personale ku përfshihen: sapuni, detergjenti, shamponi	1.15. Personal hygiene products including: soap, detergent, shampoo, toilet paper,	1.15. Proizvodi za ličnu higijenu gde se uključuju: sapun, deterdžent, šampon za

<p>për flokë, letra tualeti, letrat higjienike, pasta dhe pelenat;</p> <p>1.16. Lëndët e drurit për djegie.</p> <p>2. Lista e nënprodukteve themelore brenda kategorive, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përcaktohet dhe miratohet nga Bordi.</p> <p>3. Bordi harton dhe miraton metodologjinë për caktimin e çmimeve maksimale dhe marzhës tregtare për listën e produkteve të përcaktuar sipas këtij ligji.</p> <p>4. Bordi përcakton dhe miraton shenjën dalluese dhe kriteret për përdorimin e saj nga tregtarët për produktet themelore, për të cilat është aplikuar masa e përkohshme.</p> <p>5. Produkt themelor nuk quhet shërbimi i produktit në gastronomi.</p>	<p>hygienic paper, toothpaste and diapers;</p> <p>1.16. Wood fuel for heating.</p> <p>2. The list of essential by-products within the categories, pursuant to paragraph 1 of this Article, shall be determined and approved by the Board.</p> <p>3. The Board shall draft and approve the methodology for defining maximum prices and commercial margins for the list of products defined under this Law.</p> <p>4. The Board shall determine and approve the distinctive mark and the criteria for its use by traders for essential products to which a temporary measure has been applied.</p> <p>5. A service related to a product in gastronomy shall not be considered an essential product.</p>	<p>kosu, toaletni papir, higijenski papir, paste i pelene;</p> <p>1.16. Drveni materijal za sagorevanje.</p> <p>2. Spisak osnovnih nusproizvoda u kategorijama, prema stavu 1. ovog člana, utvrđuje se i usvaja od Odbora.</p> <p>3. Odbor izrađuje i usvaja metodologiju za određivanje maksimalnih cena i trgovinske marže za spisak proizvoda utvrđenih prema ovom zakonu.</p> <p>4. Odbor utvrđuje i usvaja razlikovni znak i kriterijume za njegovu upotrebu od trgovaca za osnovne proizvode, za koje je primenjena privremena mera.</p> <p>5. Osnovni proizvod se ne zove usluga proizvoda u gastronomiji.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Masat e përkohshme</b></p> <p>1. Masat e përkohshme për produktet themelore në raste të veçanta të destabilizimit në treg sipas këtij ligji janë:</p> <p>1.1 Caktimi i marzhës tregtare për shitjen me shumicë dhe pakicë;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Temporary measures</b></p> <p>1. Temporary measures for essential products in special cases of market destabilization under this Law shall be:</p> <p>1.1. The determination of commercial margins for wholesale and retail sales;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 5.</b> <b>Privremene mere</b></p> <p>1. Privremene mere za osnovne proizvode u posebnim slučajevima destabilizacije na tržištu prema ovom zakonu su:</p> <p>1.1. Određivanje komercijalne marže za veleprodaju i maloprodaju;</p>

<p>1.2.Caktimi i çmimit maksimal të lejuar.</p> <p>2.Masat e përkohshme caktohen në mënyrë proporcionale me nevojën për mbrojtjen e konsumatorit dhe interesit publik duke marrë parasysh barrën ndaj operatorit ekonomik.</p> <p>3.Nuk lejohen masa të tjera, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me legjislacionin në fuqi.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Shkaqet dhe kohëzgjatja e masave të përkohshme</b></p> <p>1. Masat e përkohshme nga neni 5 i këtij ligji mund të caktohen në këto raste:</p> <p>1.1 Ngritja e papritur, e menjëhershme dhe e paarsyeshme e çmimeve të produkteve themelore;</p> <p>1.2Dallime të theksuara të rritjes së çmimeve të produkteve themelore, krahasuar me vendet e rajonit.</p> <p>2.Masat e përkohshme caktohen në mënyrë proporcionale dhe hiqen kur të pushojnë shkaqet për të cilat janë caktuar.</p>	<p>1.2. The determination of the maximum allowed price.</p> <p>2. Temporary measures shall be imposed in proportion to the need to protect consumers and the public interest, taking into account the burden on the economic operator.</p> <p>3. No other measures shall be permitted, except where otherwise provided by the applicable legislation.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Causes and duration of temporary measures</b></p> <p>1. Temporary measures under Article 5 of this Law may be imposed in the following cases:</p> <p>1.1. Sudden, immediate and unjustified increase in the prices of essential products;</p> <p>1.2. Significant differences in the increase of prices of essential products, compared to countries in the region.</p> <p>2. Temporary measures shall be imposed proportionately and shall be removed once the causes for which they were imposed</p>	<p>1.2.Određivanje maksimalne dozvoljene cene.</p> <p>2. Privremene mere se određuju na proporcionalan naćin sa potrebom za zaštitu potrošaća i javnog interesa, uzimajući u obzir teret za ekonomskog operatera.</p> <p>3. Druge mere nisu dozvoljene, osim u slućajevima kada se zakonodavstvom na snazi predviđa drugaćije.</p> <p style="text-align: center;"><b>Ćlan 6.</b> <b>Uzroci i trajanje privremenih mera</b></p> <p>1. Privremene mere iz ćlana 5. ovog zakona mogu se odrediti u ovim slućajevima:</p> <p>1.1. Iznenadno, neposredno i neopravdano povećanje cena osnovnih proizvoda;</p> <p>1.2. Izražene razlike povećanja cena osnovnih proizvoda, u poređenju sa zemljama regiona.</p> <p>2. Privremene mere se određuju na proporcionalan naćin i uklanjaju se kada prestanu uzroci zbog kojih su određene.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Llogaritja e marzhës</b></p> <p>1. Për produktet e importuara për qëllim të analizës së tregut, vlerësimit të masave të përkohshme, përcaktimit të marzhës tregtare, apo përcaktimit të çmimit maksimal, kostoja referente e produkteve të importuara përfshin:</p> <p>1.1.Çmimi i blerjes së produktit;</p> <p>1.2.Kostoja e transportit, e llogaritur sipas legjislacionit në fuqi;</p> <p>1.3.Detyrimet doganore;</p> <p>1.4. Kostoja e zhdoganimit, që përfshin koston e terminalit doganor dhe shpedicionit, koston e matjes së sigurisë së produktit, si dhe koston tjetër të faturuar lidhur me zhdoganimin e produktit.</p> <p>2.Për produktet vendore për qëllim të analizës së tregut, vlerësimit të masave të përkohshme, përcaktimit të marzhës tregtare, apo përcaktimit të çmimit maksimal, kostoja referente e</p>	<p>cease to exist.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Calculation of margin</b></p> <p>1. For the purposes of market analysis, assessment of temporary measures, determination of the trade margin, or determination of the maximum price, the reference cost of imported products shall include:</p> <p>1.1 The purchase price of the product;</p> <p>1.2 Transport costs, calculated in accordance with the applicable legislation;</p> <p>1.3 Customs duties;</p> <p>1.4 Customs clearance costs, including the cost of the customs terminal and shipping services, the cost of product safety measurement, as well as other invoiced costs related to the customs clearance of the product.</p> <p>2. For the purposes of market analysis, assessment of temporary measures, determination of the trade margin, or determination of the maximum price, the</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7.</b> <b>Izračunavanje marže</b></p> <p>1. Za svrhe analize tržišta, procene privremenih mera, utvrđivanja trgovinske marže, ili utvrđivanja maksimalne cene, referentni trošak uvezenih proizvoda uključuje:</p> <p>1.1. Kupovna cena proizvoda;</p> <p>1.2. Troškovi prevoza, izračunati prema zakonodavstvu na snazi;</p> <p>1.3. Carinske obaveze;</p> <p>1.4. Troškovi carinjenja, koji uključuju troškove carinskog terminala i špedicije, troškove merenja bezbednosti proizvoda, kao i druge troškove fakturisane u vezi sa carinjenjem proizvoda.</p> <p>2. Za svrhe analize tržišta, procene privremenih mera, utvrđivanja trgovinske marže, ili utvrđivanja maksimalne cene, referentni trošak uvezenih proizvoda</p>
---	--	--

<p>produkteve të importuara përfshin:</p> <p>2.1 Kostoja e prodhimit; 2.2 Kostoja e shpenzimeve, e llogaritur sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 8 Themelimi dhe statusi i Bordit</b></p> <p>1. Me këtë ligj themelohet Bordi i Pavarur për Masat e Përkohshme për Rregullimin e Çmimeve, në raste të veçanta të përcaktuara me këtë ligj.</p> <p>2. Bordi i Pavarur i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës për ushtrimin e mandatit të tij në rrethana të veçanta të destabilizimit të tregut.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9 Përzgjedhja dhe përbërja e Bordit</b></p> <p>1. Bordi është organi më i lartë vendimmarrës dhe është përgjegjës për ushtrimin e kompetencave të përcaktuara me këtë ligj.</p> <p>2. Bordi përbëhet nga pesë (5) anëtarë, tre (3) anëtarë të jashtëm dhe dy (2) anëtarë të deleguar nga Ministria përkatëse për Industri dhe Tregti dhe Autoriteti i Konkurrencës.</p>	<p>reference cost of imported products shall include:</p> <p>2.1. Production costs; 2.2. Operating expenses are calculated in accordance with the applicable legislation.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 8 Establishment and status of the Board</b></p> <p>1. This Law shall establish the Independent Board for Temporary Measures for Price Regulation, in specific cases defined by this Law.</p> <p>2. The Independent Board shall report to the Assembly of the Republic of Kosovo on the exercise of its mandate in specific circumstances of market destabilization.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 9 Selection and composition of the Board</b></p> <p>1. The Board shall be the highest decision-making body and shall be responsible for exercising the competencies defined by this Law.</p> <p>2. The Board shall consist of five (5) members, three (3) external members and two (2) members delegated from the respective Ministry of Industry and Trade and</p>	<p>uključuje:</p> <p>2.1 Troškovi proizvodnje; 2.2 Troškovi rashoda, izračunati prema zakonodavstvu na snazi.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 8. Osnivanje i status Odbora</b></p> <p>1. Ovim zakonom osniva se Nezavisni odbor za privremene mere za regulisanje cena, u posebnim slučajevima utvrđenim ovim zakonom.</p> <p>2. Nezavisni odbor izveštava Skupštini Republike Kosova o vršenju svog mandata u posebnim okolnostima destabilizacije tržišta.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9. Izbor i sastav Odbora</b></p> <p>1. Odbor je najviši organ odlučivanja i odgovoran je za vršenje nadležnosti utvrđenih ovim zakonom.</p> <p>2. Odbor se sastoji od pet (5) članova, tri (3) spoljna člana i dva (2) člana delegirana od odgovarajućeg Ministarstva industrije i trgovine i Autoriteta za konkurenciju.</p>
--	---	--

<p>3. Kryetari, nënkryetari dhe tre (3) anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me shumicë të thjeshtë të votave.</p> <p>3.1 Kryetari duhet të zgjidhet njëri nga anëtarët e jashtëm.</p> <p>4. Ministria përkatëse për Industri dhe Tregti e inicion procedurën e përzgjedhjes, ndërsa Qeveria e miraton dhe e përcjellë në Kuvend për miratim.</p> <p>5. Pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes, Qeveria i propozon Kuvendit pesë (5) kandidatë.</p> <p>6. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para përfundimit të mandatit të një anëtari të Bordit ose pas krijimit të një vendi të lirë për arsye të tjera, Qeveria shpall konkurs publik për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit.</p> <p>7. Në rast të krijimit të një vendi të lirë në Bord para përfundimit të mandatit, Qeveria ndërmerr procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për zëvendësimin e anëtarit të Bordit në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë nen.</p>	<p>the Competition Authority.</p> <p>3. The Chairperson, the Vice-Chairperson, and three (3) members of the Board shall be appointed by the Assembly of the Republic of Kosovo by a simple majority of votes.</p> <p>3.1. The Chairperson shall be elected from among the external members.</p> <p>4. The respective Ministry of Industry and Trade shall initiate the selection procedure, while the Government shall approve and submit it to the Assembly for approval.</p> <p>5. Upon completion of the selection procedure, the Government shall propose five (5) candidates to the Assembly.</p> <p>6. Within sixty (60) days before the expiration of the term of a Board member or after the creation of a vacancy for other reasons, the Government shall announce a public call for the selection of candidates for Board members.</p> <p>7. In the event of a vacancy on the Board before the expiration of the mandate, the Government shall undertake the procedure for the selection of candidates to replace the Board member in accordance with the procedure defined in this Article.</p>	<p>3. Predsednik, potpredsednik i tri (3) člana Odbora se imenuju od Skupštine Republike Kosova prostom većinom glasova.</p> <p>3.1. Predsednik se mora izabrati jedan od vanjskih članova.</p> <p>4. Odgovarajuće Ministarstvo industrije i trgovine, pokreće proceduru izbora, a Vlada je usvaja i prosleđuje Skupštini na usvajanje.</p> <p>5. Nakon završetka procedure izbora, Vlada predlaže Skupštini pet (5) kandidata.</p> <p>6. U roku od šezdeset (60) dana pre isteka mandata člana Odbora ili nakon stvaranja praznog mesta iz drugih razloga, Vlada raspisuje javni konkurs za izbor kandidata za članove Odbora.</p> <p>7. U slučaju stvaranja slobodnog mesta u Odboru pre završetka mandata, Vlada će preduzeti proceduru izbora kandidata za zamenu člana Odbora u skladu sa utvrđenom procedurom u ovom članu.</p>
--	--	---

<p>8. Mandati i anëtarëve të Bordit është pesë (5) vjet dhe mund të rizgjidhet vetëm një herë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Kompetencat e Bordit</b></p> <p>1. Bordi ushtron funksionet dhe kompetencat e tij në mënyrë të pavarur dhe të paanshme në përputhje me këtë ligj si në vijim:</p> <p>1.1. Trajton rastet që iniciohen nga Ministria përgjegjëse për Industri dhe Tregti, Autoriteti i Konkurrencës, Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit, odat ekonomike, shoqatat përkatëse dhe institucionet tjera relevante;</p> <p>1.2. Ushtron kompetencat e tij kur konstatohet destabilizimi i tregut dhe mund të iniciojë raste që lidhen me mbrojtjen e sigurisë publike, realizimin e politikave publike me rëndësi të veçantë, mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve ose mbrojtjen e kategorive të cënueshme në situata krize;</p> <p>1.3. Bashkëpunon me Ministrinë, Autoritetin e Konkurrencës, Agjencinë e Statistikave, Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, dhe institucionet relevante përkatëse, pa cenuar pavarësinë vendimmarrëse;</p>	<p>8. The mandate of the Board members shall be five (5) years and may be renewed only once.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>Competencies of the Board</b></p> <p>1. The Board shall exercise its functions and competencies independently and impartially in accordance with this Law as follows:</p> <p>1.1. Handle cases initiated by the Ministry responsible for Industry and Trade, the Competition Authority, the Consumer Protection Council, chambers of commerce, relevant associations and other relevant institutions;</p> <p>1.2. Exercise its competencies where market destabilization is identified and may initiate cases related to the protection of public safety, the implementation of public policies of particular importance, the protection of public health, or the protection of vulnerable categories in crisis situations.</p> <p>1.3. Cooperate with the Ministry, the Competition Authority, the Agency of Statistics, the Central Market Surveillance Inspectorate and other relevant institutions, without prejudice to</p>	<p>8. Mandat člana Odbora je pet (5) godina i može biti ponovo izabran samo jednom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 10.</b> <b>Nadležnosti Odbora</b></p> <p>1. Odbor vrši svoje funkcije i nadležnosti na nezavisan i nepristrasan način u skladu sa ovim zakonom kao u nastavku:</p> <p>1.1. tretira slučajeve koji se pokreću od Ministarstva odgovornog za industriju i trgovinu, Autoriteta za konkurenciju, Saveta za zaštitu potrošača, privrednih komora, odgovarajućih udruženja i drugih relevantnih institucija;</p> <p>1.2. vrši svoje nadležnosti kada se utvrdi destabilizacija tržišta i može pokrenuti slučajeve koji se vežu sa zaštitom javne bezbednosti, realizacijom javnih politika od posebnog značaja, zaštitom zdravlja građana ili zaštitom ranjivih kategorija u kriznim situacijama;</p> <p>1.3. saraduje sa Ministarstvom, Autoritetom konkurencije, Agencijom za statistiku, Centralnim inspektoratom za nadzor tržišta i relevantnim odgovarajućim institucijama,</p>
--	---	---

<p>1.4. Ushtron funksionet e tij në bazë të analizës së tregut, evidencës ekonomike dhe parimit të proporcionalitetit;</p> <p>1.5. Analizon zhvillimet në tregjet e produkteve që i nënshtrohen këtij ligji dhe vlerëson gjendjen e destabilizimit të tregut në bazë të të dhënave objektive ekonomike dhe statistikore.</p> <p>1.6. Monitoron dhe vlerëson zbatimin e masave të vendosura dhe publikon raporte periodike mbi gjendjen e tregut, në bashkëpunim me institucionet sipas paragrafit 4 të këtij neni.</p> <p>1.7. Vendos për ndërprerjen, ndryshimin ose zgjatjen e masave në bazë të analizës së tregut;</p> <p>1.8. Anëtarët e Bordit mbledhen njëherë në tre (3) muaj dhe sipas vlerësimeve kur paraqiten indikacione të destabilizimit të tregut dhe trajtojnë rastet e përcaktuara sipas nën paragrafëve 1.1 dhe 1.2 të këtij neni.</p> <p>2. Bordi nuk mund të ndërhyjë në treg jashtë kategorive të produkteve të përcaktuara me këtë</p>	<p>its decision-making independence</p> <p>1.4. Exercise its functions based on market analysis, economic evidence and the principle of proportionality;</p> <p>1.5. Analyze developments in the markets of products subject to this Law and shall assess the state of market destabilization based on objective economic and statistical data.</p> <p>1.6. Monitor and assess the implementation of the imposed measures and shall publish periodic reports on the state of the market, in cooperation with the institutions referred to in paragraph 4 of this Article.</p> <p>1.7. Decide on the termination, modification, or extension of measures based on market analysis.</p> <p>1.8. The Board members shall meet once every three (3) months and, based on assessments, whenever indications of market destabilization arise, and shall address the cases defined under subparagraphs 1.1 and 1.2 of this Article.</p> <p>2. The Board shall not intervene in the market outside the categories of products defined by</p>	<p>nenarušavajući nezavisnost odlučivanja;</p> <p>1.4. vrši svoje funkcije na osnovu analize tržišta, ekonomske evidencije i principa proporcionalnosti;</p> <p>1.5. analizira dešavanja na tržištima proizvoda koji podležu ovom zakonu i procenjuje stanje destabilizacije tržišta na osnovu objektivnih ekonomskih i statističkih podataka.</p> <p>1.6. prati i procenjuje sprovođenje postavljenih mera i objavljuje periodične izveštaje o stanju tržišta, u saradnji sa institucijama prema stavu 4. ovog člana.</p> <p>1.7. odlučuje o prekidu, izmeni ili produženju mera na osnovu analize tržišta;</p> <p>1.8. Članovi Odbora sastaju se jednom u tri (3) meseca i, prema proceni, kada se pojave indikacije destabilizacije tržišta i tretiraju slučajeve utvrđene prema tačkama 1.1 i 1.2 ovog člana.</p> <p>2. Odbor ne može intervenisati na tržištu izvan kategorija proizvoda utvrđenih ovim</p>
---	--	--

